



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 27 mars 2018, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Valon Ramadani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fisnik Ismaili, Jasmina Zhivković dhe Imet Rrahmani.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, OSBE, BIRN, INPO, RTK, RTK Radio.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
4. Shqyrtimi i propozimeve për hartimin e draft-ligjit për transmetuesin publik të Kosovës;
5. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**Shqipe Pantina** kërkoi sqarime nga kryetari i komisionit, pse nuk është pikë e rendit të ditës P/ligji për kryeqytetin e Kosovës/Prishtinën?

**Kryetari i komisionit** u përgjigj, se ende nuk janë sqaruar disa paragrafe për nenin 7 të projektligjit që kanë të bëjnë me formimin e policisë komunale dhe për të cilat po pres sqarime nga Policia e Kosovës.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të Komisionit**

Procesverbalet u miratua pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

Nait Hasani e njoftoi komisionin se P/ligji nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në Kuvend ka arritur më 08 mars 2018, dhe komisioni brenda afatit të përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit e shqyrton p/ligjin para miratimit në parim.

Konstatim: Meqë komisioni ka qenë hartues dhe nuk pati vërejtje, miratoi unanimisht në parim P/ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nxori këtë,

## **R e k o m a n d i m**

1. Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputeti, Nait Hasani, kryetar i komisionit.

## **Arsyetim**

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional shqyrton projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

## **3. Shqyrtimi i propozimeve për hartimin e draft-ligjit për transmetuesin publik të Kosovës**

Komisioni ka vazhduar me shqyrtimin e neneve në vazhdim, nga mbledhja e mbajtur më 19 mars 2018, si vijon:

**Neni 22.2.11.** do të emërojë dhe shkarkojë drejtorin gjeneral të RTK-së.

**Neni 22. 2.12:** dy propozime: 1. shqyrtohet dhe miratohet në Bord, 2. nëse bëhet financimi miks i adresohet themeluesit. Rregullohet me Ligjin për Paga.

**Neni 23** - neni 29.1 nenet e ligjit në fuqi – paragrafët 1 deri 5 në vazhdim duhet të përfshihen në statutin e RTK –së.

1. Kur menaxhmenti i??? RTK-së nuk e miraton një vendim lidhur me aprovimin e Statutit të referuar në alinenë e gjashtë të këtij neni brenda afatit prej tridhjetë ditësh nga pranimi i Statutit të propozuar, Bordi.

2. Mbikëqyrësi i RTK-së (në tekstin e mëtejme: Bordi) mund të vendosë pa miratimin e menaxhmentit???

3. Kur menaxhmenti??? nuk ia komunikon mendimin e tij për planin e propozuar financiar të referuar në alinenë e shtatë të këtij neni Bordit, brenda tridhjetë ditëve nga pranimi i planit financiar, Bordi mund të vendosë pa mendimin e menaxhmentit???

4. Kur Bordi nuk e miraton vendimin lidhur me pajtimin për emërimin ose shkarkimin e drejtorit të radios ose të televizionit të referuar në alinenë e tetë të këtij neni brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditëve nga pranimi i propozimit, drejtori gjeneral mund të marrë vendimin përfundimtar pa miratimin e Bordit.

5. Bordi do të vendosë për rregullat dhe procedurën e tij me dy të tretat e shumicës së votave e të gjithë anëtarëve të tij, dhe për çështjet e referuara në alinetë një, dy, gjashtë dhe tetë të këtij neni. Do të vendosë për çështjet e tjera brenda kompetencës së tij me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

**Neni 24.5** Gjatë procesit të punës dhe vendimmarrjes, në Bordin e RTK-së, votimi është i hapur, **përveç në rastet kur Bordi vendos ndryshe.**

**Neni 24.6.** Bordi i RTK-së sipas këtij ligji obligohet që për punën e vet t'i raportojë themeluesit të tij, në mënyrë të rregullt dhe të jashtëzakonshme.

Neni 24.7. Raportimi i rregullt i Bordit për punën e tij, bëhet më së largu deri më 31 mars për çdo vit kalendarik. Raportimi i jashtëzakonshëm, bëhet sipas kërkesës së themeluesit.

**Neni 25.1.2 Mbetet për diskutim** 1.2. ka qenë deputet, ministër, zyrtar i lartë i pushtetit qendror apo lokal, apo anëtar i forumeve drejtuese të subjekteve politike gjatë 3 (tri) viteve të fundit;

**Neni 25.1.3.** ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose indirekt në biznesin e mediave dhe **reklamave;**

**Neni 26.1.** Drejtori gjeneral i RTK-së (në tekstin e mëtejshëm: drejtori gjeneral) do të zgjidhet nga Bordi në bazë të konkursit publik. Mandati i drejtorit gjeneral do të **jetë 5 (pesë) vjet, me mundësi rizgjedhje.**

**Neni 26.2.1.** duhet të jenë shtetas të Kosovës; **mbetet për diskutim ???**

**Neni 26.2.2.** duhet të kenë kryer universitetin dhe punë menaxheriale deri në **10 vjet; ???? për sqarim**

**Neni 26. 2.4.** duhet të ketë aftësi menaxhuese dhe organizative;

**Neni 26.4.** Kushtet e përmendura në paragrafin e dytë të Nenit 17 të këtij Ligji, po ashtu vlejné **edhe për** kandidatët për drejtor gjeneral.

Komisioni caktoj mbledhjen e radhës më 29 mars 2018 për të vazhduar me shqyrtimin e neneve në vijim.

Mbledhja përfundoi në orën:12:10.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

-----

Nait Hasani